



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 31.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, nismë e deputetit Alket Hyseni (*komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naco, Silva Caka, Adnor Shameti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Periant Teta - Drejtor i Hartimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Artur Metani – Avokati i Përgjithshëm i Shtetit

Abaz Deda – Drejtues i Zyrës së Përfaqësimit Ligjor në Avokaturën e Shtetit

Gregor Borkowski - ekspert ndërkombëtar i Misionit EURALIUS

Antuen Skënderi – ekspert i lartë vendas, përfaqësues në Misionin EURALIUS

Blerina Fani – përfaqësuese e OSBE-së në Tiranë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumine kemi për të vazhduar me çështjen që kemi sot në rendin e ditës, shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit””, nismë e deputetit Alket Hyseni. Komisioni ynë në shqyrtimin e këtij projektligji është komision përgjegjës dhe relatore është kolegja Klotilda Bushka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë, zoti Periant Teta, Drejtor i Hartimit të Legjislacionit. Nga Avokatura e Shtetit, zoti Artur Metani, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit dhe zoti Abaz Deda, drejtues i Zyrës së Përfaqësimit Ligjor. Nga Misioni Ndërkombëtar EURALIUS, zoti Gregor Borkowski, ekspert ndërkombëtar dhe zoti Antuen Skënderi, ekspert i lartë vendas. Nga prezenca e OSBE-së në Tiranë, e pranishme është zonja Blerina Fani.

Mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Para se t’ia jap fjalën propozuesit, zotit Alket Hyseni, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve të komisionit se ligji për Avokaturën e Shtetit, është një ndër projektligjet e reformës në drejtësi që i përket paketës së dytë prej 27 ligjesh. Është një ligj i rëndësishëm, e vlerësoj punën e kolegëve dhe seriozitetin me të cilin kanë punuar për këtë projektligj, po ashtu edhe ekspertët vendas, por edhe ata ndërkombëtarë për përkushtimin e tyre në draftimin e këtij ligji, të cilin shpresoj ta votojmë sot në parim dhe në mbledhjet e radhës ta kalojmë nën për nën e më pas në seancë plenare. Është programuar për t’u votuar në datën 22 nëntor, sipas kalendarit të miratuar në Konferencën e Kryetarëve.

Faleminderit për prezencën tuaj sot në komision!

Fjalën e ka kolegu Alket Hyseni, si propozues i këtij ligji.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni ta filloj fjalën time duke i uruar mirëseardhjen Avokatit të ri të Shtetit, detyra e të cilit përkon edhe me diskutimet për miratimin e këtij ligji. Unë kam dy herë kënaqësi që të diskutoj edhe në cilësinë zyrtare të Avokatit të Shtetit, por edhe në cilësinë e një juristi të shkëlqyer, siç është zoti Metani.

Suksese, zoti Metani!

Uroj që diskutimet e këtij ligji do të ecin për së mbari dhe në një kohë shumë të shkurtër, për t'i dhënë mundësi avokaturës tashmë me eksperiencë 20-vjeçare, në mos gaboj që nga '99-a, rolin dhe vendin që i takon si institucion. Në kuptimin institucional është konsoliduar, por lëvizjet në vite nuk është se e kanë përmirësuar vazhdimisht, gjë që ka sjellë edhe problematika në aktivitetin e saj. Pikërisht ky ka qenë synimi i kësaj iniciative, përmirësime ligjore të domosdoshme për t'i dhënë avokaturës rolin dhe vendin e saj si një institucion i nivelit të lartë në mbrojtje të interesave pasurore shtetërore, i pandikuar dhe i pavarur qoftë nga ministri apo ministra të caktuar, duke e ringritur vartësinë e këtij institucioni në vartësinë e Këshillit të Ministrave, për ta bërë atë më pranë interesave të drejtpërdrejta shtetërore dhe larg ndikimeve dhe influencave të ministrit të linjës apo interesave të ngushta personale.

Pavarësisht se është diskutuar shumë, pavarësisht se pas një analize të plotë që është bërë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë në kuadër të reformës në drejtësi ka punuar jashtëzakonisht mirë, mendoj se këto diskutime mund ta përmirësojnë këtë ligj për ta bërë atë që t'i qëndrojë kohës.

Suksese të gjithëve!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Të falënderoj për urimin që i bëtë Avokatit të ri të Shtetit, por edhe unë po e uroj për së dyti në emër të komisionit dhe të të gjithë kolegëve të mi, urime dhe suksese!

Fjalën e ka relatorja e këtij projektligji, Klotilda Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, kryetar!

Edhe unë e kam për kënaqësi t'i uroj punë të mbarë në detyrën e re Avokatit të Shtetit!

Më vjen mirë që jemi në këtë takim të parë në Komisionin e Ligjeve me Avokatin e ri të Shtetit, për të diskutuar pikërisht ndryshimet në ligjin kuadër që rregullon veprimtarinë e Avokaturës së Shtetit, i cili, në fakt, është pjesë e ligjeve të reformës në drejtësi dhe si i tillë ka një vëmendje më të shtuar nga Kuvendi, por edhe nga qeveria sa u takon disa çështjeve të rëndësishme, që kanë të bëjnë me forcimin e institucionit në kuadër të një korpusi të ri të ligjeve të drejtësisë, rritjen e pavarësisë, të eficiencës, të profesionalizmit në bazë të së cilës ky institucion do të duhet të ofrojë shërbimet e veta dhe rikarakterizimin e këtyre shërbimeve jo vetëm në momentin kur lindin konfliktet, por që në procedurat paraprake, të konsultimit të organeve shtetërore me Avokaturën e Shtetit, përpara se të fillojë një vendimarrje.

Pra, është rritur, me risitë që sjell projektligji, mënyra e konsultimit dhe janë shtuar hallkat në bazë të së cilës organet e shtetit sot do të duhet të konsultohen me Avokaturën e Shtetit para se

të marrin një vendimmarrje të rëndësishme, siç janë kontratat publike apo procedurat publike për gara të ndryshme sa u takon shërbimeve dhe prokurimeve publike.

Pra, ikën nga një institucion që merrej vetëm me pjesëmarrjennë zgjidhjen e konflikteve i jepet një rol thelbësor edhe në pjesën e parandalimit të konfliktit duke qenë pjesë në konsultimet e vazhdueshme paraprake para vendimmarrjes administrative.

Çështja e dytë ka të bëjë me faktin e një mekanizmi më shterues dhe më të detajuar sa i takon rolit që ka Avokatura e Shtetit për ekzekutimin e detyrimeve që Shqipëria ka si rrjedhojë e vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Ne kemi mekanizmat tonë konkretë, të cilët janë vlerësuar së fundi edhe nga komiteti i ministrave të Këshillit të Europës, si hapa pozitivë në drejtim të ekzekutimit të detyrimeve që i lindin Shqipërisë nga vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, por saktësimi i mekanizmave konkrete të detajuar aq sa duhet në një ligj si një risi që vjen në këtë projektligj, është një hap i përshëndetur dhe që plotëson në të njëjtën kohë edhe detyrimin që ka Kuvendi në kuadër të rezolutave të Asamblesë Parlamentare dhe të Europës sa i takon monitorimit të detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Siç e dimë, çështjet kryesore që kanë peshë në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut, që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës, qytetarët shqiptarë kërkojnë një vëmendje të shtuar, siç ka ndodhur gjatë të gjithë këtyre viteve, por edhe garanci normative, duhet të jenë të parashikuara shprehimisht në ligj. Kjo është një risi, e cila përshëndetet në nismën që ka paraqitur kolegu ynë Hyseni dhe që është punuar nga ekspertët e nivelit të lartë Euralius 1, pjesa tjetër ka të bëjë me statusin që u jepet avokatëve të Shtetit në të gjitha zyrat e institucionit, nga niveli hierarkik më i lartë deri në nivelin më të poshtëm, në mënyrë që t'u krijohen edhe garanci statusore, pra sa i takon pozicionit të tyre në administratë edhe shpërblimeve financiare, në mënyrë që ky institucion dhe aktorët që punojnë në të të kenë dinjitetin që i takon në sistemin tonë të së drejtës, në mënyrë që shërbimi që ofrohet të jetë i cilësisë së standardeve të përafëruara me ato ndërkombëtare.

Çështja e trajtimeve të drejtave dhe detyrimeve të statusit të avokatëve të shtetit, por edhe e kompensimit ose shpërblimit të pagës së tyre është një çështje, në diskutim të vazhdueshëm me Ministrinë e Financave, e cila në diskutimin nën për nen do të jetë, le të themi, aktori kryesor për të vendosur përfundimisht se cili do të ishte një model i mirë që arrin qëllimin e ligjit, por në të njëjtën kohë u përshtatet mundësive buxhetore të Shqipërisë dhe u përafërohet standardeve që ne kemi arritur me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi për të gjitha institucionet e drejtësisë.

Përafrimi që bëhet përmes këtij draftligji me të gjithë korpusin e të drejtës civile dhe procedurale civile, që tashmë është e miratuar në Shqipëri, është, gjithashtu, një risi e ligjit, sepse do të na duhet patjetër të harmonizojmë edhe procedurat e zyrës së Avokaturës së Shtetit me çfarë ndodh sot konkretisht nëpër gjykata dhe në zyrat tona administrative, ku gjen zbatim e drejta civile administrative ose të drejtat procedurale, sepse në ligjin vjetër sigurisht nuk janë reflektuar ndryshimet përkatëse dhe është një risi që ligji e sjell në mënyrë që të mos kemi bllokim ose paqartësi në punën e Avokaturës së Shtetit. Çështjet e rregullave procedurale sa i takon disiplinës në institucion janë, gjithashtu, risi të ligjit, të cilat janë të përafuara me standardet ndërkombëtare dhe këto garantojnë procesin e rregullt, si dhe procedurën në kuadër të zbatimit të parimeve të procesit të rregullit ligjor. Këto janë kryesisht risitë e ligjit.

Gjithsesi, në konsultim me EURALIUS-in, me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, që veprojnë në Shqipëri dhe që kanë këshilluar këtë komision, por edhe Kuvendin dhe qeverinë lidhur me ligjet e reformës në drejtësi, jemi në komunikim të vazhdueshëm për t'i dhënë ligjit në diskutimin nen për nen trajtën përfundimtare për t'ia paraqitur këtij komisioni. Në mbledhjen e radhës që do të jetë për diskutimin nen për nen do të vijmë me një draft integral ku do të reflektohen të gjitha komentet dhe sugjerimet jo vetëm të partnerëve ndërkombëtarë, institucioneve të administratës qendrore, por edhe të grupeve të interesit, të cilat do të jenë pjesë e diskutimeve dhe dëgjësave lidhur me këtë çështje.

Faleminderit! Shpresoj në miratimin dhe mbështetjen tuaj të këtij ligji në parim.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Përfaqësuesi nga Avokatura e Shtetit, avokati i përgjithshëm i shtetit, zoti Metani.

Artur Metani – Faleminderit, për ftesën dhe për punën e bërë nga deputeti propozues, ekspertët e EURALIUS-it dhe ekspertët e nivelit të lartë që kanë përgatitur këtë projektligj, sepse u ka shkuar për shtat shumë nevojave që Avokatura e Shtetit ka hasur në vite. Në fakt, Avokatura e Shtetit ndër vite ka pasur diskutime për ta reformuar institucionin, për të ardhur sa më mirë në rritjen e performancës për dhënien e këshillimit dhe përfaqësimit që bën Avokatura e Shtetit në rritjen e garancive për punën e avokatëve të shtetit dhe sigurisht rritjen kapaciteteve profesionale që avokatët e shtetit mund të përfitojnë nga Shkolla e Magjistraturës. Në këtë këndvështrim të gjitha ndryshimet ligjore të propozuara nga deputeti ne i gjejmë brenda natyrës dhe nevojave që ka institucioni dhe mbështesim këtë projektligj. Kemi edhe disa gjëra teknike, të cilat do t'jua dërgojmë me shkrim. Gjithashtu, ne do të marrim pjesë në diskutimet nen për nen.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me projektligjin, zoti Teta.

Periant Teta – Faleminderit zoti Manja!

Ministria e Drejtësisë është njohur me përmbajtjen e projektligjit. Sa u parashtrua nga deputeti propozues, si edhe relatori i këtij projektligji, ky ligj adreson një sërë çështjesh, të cilat janë evidentuar në problematikat e analizës së sistemit të drejtësisë, që është një dokument i krijuar në kuadër të komisionit të posaçëm të reformës në drejtësi. Njëkohësisht, ne adresojmë një sërë problemesh, të cilat kanë ardhur nga zbatimi në praktikë i legjislacionit aktual sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksionit të avokatit të përgjithshëm të shtetit apo edhe të veprimtarisë së tyre administrative në kuadër të këshillimit dhe përfaqësimit ligjor. Ministria e Drejtësisë e mbështet këtë iniciativë të deputetit, megjithatë kontributet konkrete do t'i japim në kuadër të diskutimit të projektligjit nen për nen.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Përfaqësuesit e misionit ndërkombëtar EURALIUS, zoti Borkowski, ekspert ndërkombëtar.

Gregor Borkowski - *(perkthen perkthyesi)* Së pari, dëshiroj t'ju falënderoj dhe është hera e parë që marr pjesë në Komisionin e Ligjeve.

Unë jam gjyqtar polak dhe aktualisht jam ekspert ndërkombëtar në misionin EURALIUS.

Për sa i takon përshtypjes së EURALIUS-it, qasja jonë për vlerësimin e përgjithshëm të këtij projektligji, të cilin e shikojmë të fokusuar në dy aspekte kryesore, është pozitive.

Së pari, lidhet me ndryshimin e statusit dhe së dyti, lidhet me aspektin politik, sepse gjithçka që do të jetë në këtë ligj do të jetë në përfrim me standardet europiane

Për sa i takon çështjes së dytë, ne do të fokusohemi në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Mendojmë se duhet të zhvillohet më tej dhe duhet ta përcaktojmë këtë në mënyrë më të detajuar. Pra, do të keni mbështetjen tonë kur të flasim më tej.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

Nga prezenca e OSBE-së në Tiranë ka përfaqësues?

Mund të shpreheni aty.

Zonja Fani, OSBE-ja e ka parë projektligjin?

Blerina Fani Ne i kemi bërë komentet tona me shkrim, të cilat i kemi dorëzuar dhe do ta ndjekim diskutimin edhe nen për nen. Për momentin nuk prononcohem, por komentet tona i kemi bërë dhe shpresojmë që të merren parasysh.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit prezencës së zyrës së OSBE-së!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Meqë po e diskutojmë në parim, kam një pyetje përgjigjen e së cilës nuk po e gjej dot. Cila është arsyeja që Avokatura e Shtetit të kalojë nga varësia e ministrit të Drejtësisë në varësi të Kryeministrit? Mendoj se Kryeministri ka mjaft agjenci në varësi dhe nuk besoj se kjo e bën më eficiente punën.

Besoj se Ministria e Drejtësisë është institucioni i duhur dhe kushtetues që mund t'i atashohet kjo strukturë e rëndësishme për qeverinë dhe në përgjithësi për të gjitha agjencitë qeveritare. Cila ka qenë arsyeja? Eksperti tha që nuk është çështje standardi, por zgjedhjeje, kështu që ne do të bëjmë një zgjedhje dhe duhet ta dimë pse po e bëjmë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çuçi! Relatorja ka një përgjigje për këtë pasi kemi qenë në kontakt dhe diskutime për këtë pikë.

Klotilda Bushka – Kjo është një çështje, që, siç e thashë në fillim, do të jetë pjesë e diskutimit nen për nen. Ne do të krijojmë një grup me të gjithë aktorët e përfshirë për të kuptuar se cila do të ishte një nga mënyrat më të mira që do t'i jepte efektivitet punës së institucionit.

Propozimi fillestar i ekspertëve të nivelit të lartë të EURALIUS-it ka qenë ky, kjo duke pasur parasysh një analizë të sistemit të drejtësisë për sa i takon llojit të qartësisë së kompetencave të avokatit, kryesisht në përmbushjen e detyrimeve që vijnë nga vendimet ndërkombëtare, duke pasur parasysh që në një farë mënyre është qeveria dhe entitetet e saj, ministritë përkatëse, që janë të detyruara me zbatimin kryesor të vendimeve.

Gjithsesi, kjo është një çështje e hapur, për të cilën ne ende nuk kemi diskutuar në detaje, e cila do të jetë pjesë e diskutimeve të grupit të punës kur të bëhet diskutimi nen për nen.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Çuçi!

Bledar Çuçi – Meqë dëgjova të fliste edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, dua të di nga Ministria e Drejtësisë nëse ka qenë problem fakti që Avokatura e Shtetit ka qenë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë? Pra, ju e shikoni si një gjë të mirë projektin, sepse thatë që jeni shumë

dakord? Presupozohet që jeni dakord me këtë lëvizje të varësisë. Mendoni se deri tani atje nuk ka shkuar mirë puna dhe do të arrini ... ?

Ulsi Manja – Nga Ministria e Drejtësisë?

Periant Teta - Për sa u diskutua, vendimmarrja ndoshta mund të kërkojë edhe qasje politike, kurse për sa i takon aspektit teknik këto do të parashtrohen si çështje kur të diskutohet nen për nen. Aty do të ballafaqohen argumentet pro dhe kundër dhe ndoshta vendimmarrja do t'i takojë këtij komisioni.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Teta!

Ka pyetje të tjera?

Po, një sugjerim nga zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Unë i dëgjova me kujdes relatoren dhe propozuesin. Këtu ka një material shumë interesant. Ka shumë pyetje për të bërë, por ne do të donim që në momentin që do të diskutojmë nen për nen të kishim një draft-material të paraqitur nga relatorja, me mendimin edhe të përfaqësuesve që janë këtu, për ndryshimet e mundshme.

Pyetja ime ka të bëjë me shtimin e zyrave të Avokaturës së Shtetit me zyra vendore. Si do të shtohen zyrat vendore? Ku do të jenë? Çfarë funksioni do të kenë? Avokatura e Shtetit e ka për detyrë, se mbron pronat e shtetit, mund të jetë e pranishme pa marrë leje nga askush në çdo gjyq që bëhet në çdo bashki. Zyrat vendore do të shtohen në 61 bashki apo do të shtohen në rangun e prefekturave? Ka shumë pyetje teknike, të cilat unë nuk po i ezauroj sot këtu me idenë se drafti, që do të na paraqitet nga relatorja, do të jetë i pajisur me ndryshimet e nevojshme me ligjin aktual apo edhe me idenë e re se çfarë do të sjellë ligji i Avokaturës së Shtetit. Këtë sugjerim kisha.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit dhe urime zoti Metani!

Unë kam një pyetje për përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë. Kjo është një nismë e deputetit dhe projektligji ka qenë në kuadër të punës që ka bërë komisioni *ad hoc* i reformës në drejtësi. Që nga ajo kohë kanë kaluar gati 2 vjet. A ka Ministria e Drejtësisë një studim për problematikat që ju keni hasur si avokat i shtetit në raport me vendimet e Gjykatës së Strasburgut, me sistemin gjyqësor në Shqipëri, pra, sa janë të pranishëm, sa mundësi kanë ndjekur, sa gjyqe

janë fituar, dhe për cilësinë e avokatëve të shtetit? Këtu shikoj që ka propozime për kritere që duhet të përmbushin, por që të votojmë një propozim duhet të kemi parasysh çfarë problemesh janë konstatuar për pagën, cilësinë, marrëdhëniet me Shkollën e Magjistraturës e të tjera.

Së fundi, a keni ndonjë studim për problematikat që keni pasur në raport gjykimet ose kontratat në organet e qeverisjes vendore dhe ato qendrore, të cilat duhet të rregullohen më mirë në projektligjin që ne kemi?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Do t'ju lutesha që kush do të përgjigjet ta bëjë në mënyrë të përmbledhur pasi jemi në votimin në parim. Sot kemi shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji dhe shumë çështje që u ngritën këtu me të drejtëedhe nga kolegët, do të diskutohen në shqyrtimin dhe miratimin nën për nen.

Do t'ju lutesha për një përgjigje. Kush do të përgjigjet? Ministria e Drejtësisë?

Po, zoti Teta.

Periant Teta – Meqenëse pyetja u adresua drejtpërdrejt për Ministrinë e Drejtësisë, ndoshta me të vërtetë kërkohet një qasje apo një vlerësim paraprakisht teknik, si dhe mënyra se si do t'i adresojë ligji i ri të gjitha këto çështje apo problematika.

Në fakt, është një çështje për diskutim, sepse kjo është një nismë deputeti dhe Ministria e Drejtësisë merr pjesë në këtë komision si palë e interesuar. Megjithatë, patjetër që Ministria e Drejtësisë do të japë kontributin e saj për këto çështje dhe do të jetë një aktor shumë aktiv dhe proaktiv, në ndihmë të procesit dhe hartimit të një projektakti sa më të mirë, që të gjejë zbatim në praktikë.

Momentalisht, nuk mund të jap një përgjigje të saktë për çështjet e ngritura dhe për problematikat që mund të jenë hasur në praktikë. Megjithatë, kur të diskutohet nën për nen, ne do ta ndihmojmë këtë proces, me të dhëna, raporte, si dhe me gjithë informacionin që zotëron Ministria e Drejtësisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Teta!

Si nismëtar i projektligjit, zoti Hyseni ka kërkuar fjalën.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Në përmbyllje, doja t'u thosha kolegëve që në këtë ligj ka shumë gjëra për të diskutuar. Synimi nuk ka qenë për të bërë një draft që nuk do të kishte diskutime, duke qenë se problematikat

kanë qenë të mëdha dhe kemi qenë para disa fakteve tashmë jo thjesht të bëra me analizë (duke iu referuar edhe pyetjes së koleges Hysi), por të konstatuara në raporte të ndryshme nga praktika e punës së Avokaturës, ku në realitet shteti nuk ka pasur avokatin që meritonte.

Interesat shtetërorë shpesh nuk kanë pasur mbrojtjen që kanë merituar dhe jo më kot publiku e ka konsideruar ndonjëherë si të lënë pas dore shtetin, si ai thesi i madh ku ka vend për të gjithë për të futur dorën dhe nuk ka kush e mbron.

Ka ardhur koha të mos merreni më me zgjidhje spontane, të cilat vareshin nga ndërgjegjja e disa avokatëve që kanë punuar me përkushtim atje, por për të ngritur një sistem. Nuk ka fare rëndësi se ku do të jetë varësia, por se çfarë sistemi do të ngremë, si do të krijohet ky institucion, në mënyrë që të jetë i paprekshëm dhe i painfluencuar nga askush. Ky është synimi dhe unë besoj që këtë do të realizojmë në diskutimin nen për nen.

Le t'u japim avokatëve statusin që meritojnë. Le t'i japim këtij institucioni vendin që meriton. Le t'i japim shtetit avokatin më të mirë të mundshëm, atij shteti që ne, socialistët, kemi premtuar që do ta bëjmë më të fortë, atij shteti që meritojnë shqiptarët.

Prandaj, ftoj kolegët që sot t'i mbyllin diskutimet në parim dhe t'i lëmë kohë vetes. Natyrisht, relatorja do të paraqesë një relacion të detajuar rreth asaj që ofron drafti, rreth elementeve për diskutim, si dhe propozimet e saj dhe të grupeve të interesit, që kur të vijmë te diskutimi nen për nen, të bëjmë përmirësimet e duhura, në mënyrë që trupës së Avokaturës t'i japim një ligj të ri, por edhe një funksion të merituar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Nga kolegët ka dikush për të shtuar, përpara se ta votojmë?

Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një ndërhyrje, jo për pyetje, por për një sugjerim.

Meqenëse ka qenë në praktikën e punës së këtij komisioni, për lehtësi pune, do t'ju sugjeroja (besoj se kam edhe mbështetjen e anëtarëve të tjerë të këtij komisioni) që herën tjetër të punojmë me një tabelë, ku të jetë ligji siç është, si propozohet të bëhet dhe, natyrisht, të jenë edhe vërejtjet që ka secili, relatori, OSBE-ja, EURALIUS-i e me radhë.

Së dyti, me sa kuptoj nga leximi i relacionit, synohet të ndryshohet statusi i Avokatit të Shtetit, duke e njësuar atë me statusin e prokurorit (kështu thuhet, por prokurori dhe gjyqtari kanë të njëjtin status: statusin e magjistratit). Minimalisht, kjo ka edhe një faturë financiare. Kështu që

doja ta sillja në vëmendjen tuaj (ne e kemi edhe detyrim kushtetues) për ta bashkërenduar me Ministrinë e Financave këtë çështje, me Këshillin e Ministrave, nëse jemi në gjendje, që, në momentin kur do ta pranojmë këtë gjë, të mund ta përballojmë edhe financiarisht, sepse janë një sërë faturash që kemi marrë përsipër për shkak të ndryshimeve ligjore që kemi miratuar në parlament. Për këtë e kisha ndërhyrjen.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Felaj!

Ka diskutime? Nuk ka.

Përpara se ta hedh në votim në parim këtë projektligj, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve dy gjëra, në lidhje me ato që tha edhe kolegja Felaj.

Drafti që do të diskutojmë nen për nen, do të jetë një draft i integruar, në formë tabelore, sigurisht, siç është vepruar me të gjitha draftet e reformës në drejtësi që kemi diskutuar dhe miratuar në këtë komision.

Për sa i përket faturës financiare, e kemi diskutuar si çështje. Ndaj, kërkoj nga relatorja, por edhe nga këshilltarët, të jemi në kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Financave. Kemi një material të ardhur në datën 15.10.2018 nga Ministria e Financave, në përgjigje të kërkesës sonë si komision për faturën financiare të këtij projektligji, që është goxha faturë. Natyrisht, Ministria e Financave është shprehur pozitivisht për faturën financiare të këtij projektligji, por pret miratimin nen për nen të ligjit, për të parë se cili do të jetë trajtimi financiar dhe statusi që do t'i jepet zyrës së Avokatit të Shtetit, në lidhje me trajtimin financiar të avokatëve, por edhe të stafit të Avokaturës së Shtetit.

Gjithsesi, të gjitha këto sugjerime, që u bënë sot nga kolegët, janë mbajtur shënim nga relatorja, nga këshilltarët e komisionit, si dhe nga nismëtari i projektligjit.

Ftohen të gjithë kolegët të japin kontributin në miratimin e këtij projektligji shumë të rëndësishëm.

E hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit””?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit””.

Me miratimin në parim të këtij projektligji e mbyllim mbledhjen e Komsionit të Ligjeve për sot.

Shumë faleminderit për prezencën, kolegëve, përfaqësuesve të Avokaturës së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, misionit EURALIUS, OSBE-së, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë!

Ju njoftoj se mbledhja e radhës së komisionit, së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA